

V E N D I M
Nr. 521, datë 21.9.2000

**PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT ME STREHIM TË DISA FAMILJEVE, TË VENDOSURA
NË MJEDISËT E DEGËS SË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE, SH.A. DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8634, datë 6.7.2000, “Për miratimin e marrëveshjes së shitjes së aksioneve të shoqërisë anonime “Banka Kombëtare Tregtare”, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Kent Bank, Koorporatës Ndërkombëtare Financiare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të trajtohen me strehim nga Enti Kombëtar i Banesave familjet e vendosura në mjediset e degës së bankës Kombëtare Tregtare, Durrës, në masën:

Familja Çiraku	2 apartamente 2+1 dhe 1 apartament 1+1
Familja Çoma	1 apartament 3+1
Familja Ndreca	1 apartament 2+1
Familja Keraj	1 apartament 2+1

2. Kredia të jepet pa interes, me një afat kthimi 25 vjeçar.

3. shuma prej 12.737 milionë lekësh, e nevojshme për trajtimin me strehim të familjeve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe të vendoset në një llogari “escrow”, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a., në emër të Entit Kombëtar të Banesave.

4. Afati përfundimtar i lirimit të mjediseve në degën e Bankës Kombëtare Tregtare, Durrës, të jetë data 10 janar 2001.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta